



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	23.04.2025
REFERENC-Ë:	7880/24 ZSP - 2025
PËR/ZA/TO:	K. Shtime
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI Drejtori ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të Drejtën Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Pëlqim ujq

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bazuar në kërkesën me Nr. Protok. 7880/24, datë 02.12.2024, lidhur me projektin "Pastrimi dhe rregullimi i Lumenjëve në Shtime, Rashincë; Vojnoc; Muzeqenë" K. Shtime. Pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planinng and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. PU

Datë: 23.04.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, U.A. MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa me nr. Protok. 7880/24, për **Pëlqim Ujor, për kalim në kompetencë të Komunes Shtime**, për projektin "Pastrimi dhe rregullimi i Lumenjëve në Shtime, Rashincë; Vojnoc; Muzeqenë" :

1. Pëlqimi Ujor lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv, për
LOT 1- Shtimjanka në distancë $L=1900\text{ m'}$, nga pika fillestare gjeodezike ($X=7\ 502860.792$; $Y=4\ 698\ 878.22$) dhe pika perfundimtare ($X=7\ 504\ 161.52$; $Y=4\ 699\ 613.518$);Për ngastren P-72809093-02690-0;Z.K. Shtime;
LOT 2 – Shtimjanka në distancë $L=4\ 745\text{m'}$ nga pika fillestare gjeodezike Shtime, Rashnicë, deri në Muzeqinë;P-72809015-00916-0;Vojnoc, P-72809023-00435-0; Davidoc; P-72809023-00436-0; Davidoc, P-72809072-00036-0; P-72809072-00990-0; P-72809072-00453-0; P-72809072-00991-0;Z.K.Rashnicë; P-72809058-01200-0; Muzeqinë;
LOT 3 – Shtimjanka në distancë $L=3845\text{m'}$ Muzeqin – Vojnoc;
2. Pastrimi i segmentit të lumenjëve të behet bazuar në legjislacionin e ujërave, si dhe Direktivave për lumenjtë;
3. Nuk lejohet betonim i bentosit, si dhe duhet pas kujdes që të ruhet rrjedha natyrore

4. Lumi duhet te lirohet nga futja në tuba, dhe te njejëtat të zavendesohen me ura kaluese mbi lum;
5. Materiali i deponuar për shkak të grumbullimit të mundëshëm gjatë ndryshimit të kushteve klimatike, për të cilin parashihet nevoja për largim, ku konsiderohet se pengon lëvizjen e natyrshme të ujërrjedhës ose parashihet si rrezik potencial të krijoj vërshime, Organi Komunal i cili është i obliguar të bëjë mbikqyrjen e zhvillimi të punimeve të cilat duhet të jen në përpuethshmëri të plotë me dispozitat ligjore për ujëra, njëkohsisht duhet ti paraqes profilet, ku është nxjerrë materiali, të kalkuloj kubaturën si dhe të bëjë pagesën e materialit sipas dispozitave te parapara në fuqi;
6. Elaborati i dinamikës së nxjerrejs së materialit, dhe rehabilitimi pas këtijë aktiviteti të prezantohet në formë ditari për secilin segment, në MMPHI, konformë “U.A MMPH 03/2018, për procedurat për leje ujore”;
7. Kërkesa e mirëmbajtes nuk mund të jet afatgjate, sepse siq është cekur më sipër pëlqimi uxor ka afat një vjeçar, dhe pas kalimit të kësajë periudhe kohore, pala duhet të bëjë kërkesë të veçant, po që se paraqitet nevoja, sepse aktualisht me legjislacionin në fuqi nuk parashihet ndryshe;
8. Pëlqimi uxor për nxjerrjen e materialit ndërpritet edhe para afatit të përcaktuar nga paragrafi si më sipër, nëse gjatë kontrollit nga inspektorati i ujërave komunal dhe qendrorë, vërtetohet se kryesi i punëve nuk iu është përmbajtur kushteve të përcaktuara me pëlqim uxor;
9. Raportet duhet të jenë të nënshkruara dhe me datë, në ditën kur janë kontrolluar nga organi mbikqyrës i Komunës së Shtimes;
10. Vendi për deponimin e materialit, duhet të jet i caktuar, dhe me prezantim të ngastrës së paraparë dhe për çdo ndryshim pala duhet ta informoj Organin i cili e ka lëshuar këtë Pëlqim Uxor;
11. Pala detyrohet që të bëjë inçizimin gjeodezik të shtratit të segmentit të lumit të pastruar, pas kryerjes së punimeve dhe të njëjëtën ta prezantojë pranë Organit që e ka lëshuar Pëlqimin uxor;
12. Pastrimi i dërrunjëve nuk është në Kompetencë të MMPHI-së dhe duhet të kërkohet nga organi përgjegjës, sepse ARPL-ja nuk ka kompetenca përveq se organi kompetent;
13. Punëkryesi i detyrohet MMPHI-së, që materialin ranor dhe gurorë të larguar ta prezantojë realisht si dhe vendëndodhjen, pranë organit përgjegjës që e ka lëshuar këtë Pëlqim uxor, për shkak të vlerësim financiar, sipas U.A për strukturën e pagesave në fuqi;

ARSYETIM

Pala, Komuna Shtime ka aplikua për Pëlqim Ujor, lidhur me “Pastrimi dhe rregullimi i Lumenjëve në Shtime, Rashincë; Vojnoc; Muzeqenë”. Kërkesës ka bashkangjitur: Certifikata e nr. Fiskal; Kopje e planit për ngastren P-72809093-02690-0; Z.K.Shtime, P-72809015-00916-0; Vojnoc, P-72809023-00435-0; Davidoc; P-72809023-00436-0; Davidoc, P-72809072-00036-0; P-72809072-00990-0; P-72809072-00453-0; P-72809072-00991-0; Z.K.Rashnicë; P-2809058-01200-0; Muzeqinë; Certifikata e Pronësisë; Bashkangjitur Raporti teknik; Situacioni i terrenit për Shtime, Rashincë, Muzeqinë. Profilet gjatësore për Lot 1 dhe Lot 2; Profilet karakteristike të pikave stacionare, gjithsejtë nga (st. 0- st. 171); Lot 3; - Pjesa tekstuale - Raporti teknik ; zgjidhja teknike; paramasa e punëve ndërtimore; Pjesa grafike: Situacioni, profili gjatësor; profilet karakteristike , detalet për segmentin nga Ura në Muzeqinë dhe lumit të Shtimes , me degët e tjera; bashkangjitur për këtë Hidrologjia, Hidraulika – dimensionimi i shtratit të Lumit; paramasa dhe parrallogaria për Lot 3, nga (stac.0 –stac. 155); – Shtimjanka në distancë $L = 3845m$ Muzeqin – Vojnoc; situacioni 1:2000, Muzeqinë – Vojnoc; Profili gjatësor; Profilet karakteristike 1:50;

Vërejtje:

- Ky projekt do të realizohet, me qëllim të mbrojtjes së regjimit të ujërave, shtratit dhe brigjeve të lumit,
- Poashtu K. shtime thekson se pastrimi i shtratit të lumit është më se i nevojshëm pasi që janë barrtur mbeturina të shumta brigjeve të tijë, të cilat po pengojnë rrjedhën e ujit dhe në raste të vërshimeve;
- Nëse vie deri te prishja e regjimit të ujërrjedhës, ose i shkaktohet dam palës së tretë, gjatë realizimit të punimeve, punëkryesi detyrohet që dëmet ti eliminoj dhe të njejëtat ti kompenzoj;

Andaj bazuar në kërken e K. Shtime, për “Pastrimi dhe rregullimi i Lumenjëve në Shtime, Rashincë; Vojnoc; Muzeqenë” dokumentacionit – investivo teknik të hartuar, është vendosur si në dispozitiv të këtijë vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 7880/24 – ZSP - 2024 Datë: 23.04.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Komunës Shtime;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të Ministrisë.

U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedin BYTYQI